

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Dalip Bega-kryetar kolegji, Biljana Regjiqi dhe Ragip Namani-anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Sebahate Hoti, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga i pandehuri Munir Basha nga Prizreni, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore-divizioni për Kundërvajtje, në Prizren, Nr.473-05/12, datë 09.01.2013, në bazë të nenit 39,219 dhe 222 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 02.04.2013, merr

AKTVENDIM

Ankesa e paraqitur është e **BAZUAR**.

ABROGOHET aktvendimi i atakuar dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

Arsyetim

Gjykata Themelore-divizioni për Kundërvajtje në Prizren, sipas aktvendimit Nr.473/12, të datës 09.01.2013, të pandehurin nga Prizreni, e ka shpallur përgjegjëse sepse në cilësinë e zyrtarit të lartë publik, nuk e ka përmbushur obligimin ligjor që parashihet në Ligjin 04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik, me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 5,6, par.1.3 dhe neni 9 lidhur me nenin 17 paragrafi 1.3 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe kontrollimin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, dhe në vështrim të nen.9 të LK i ka shqiptuar dënimin me gjobë në shumë prej 500.-€ (pesëqind euro), duke e obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 5.-€ (pesë euro).

Kundër këtij aktvendimi i pandehuri ka paraqitur ankesë për shkak të:

- shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kundërvajtëse,
- vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe
- aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe
- vendimit mbi dënimin.

Në arsyetim të ankesës përpos tjerash thekson se dispozitivi është i pakjartë, konfuz dhe në kundërshtim me arsyetimin, se gjendja faktike nuk është vërtetuar sa dhe si duhet, se në deklarimin e tij para gjykatës së shkallës së parë nuk e ka pranuar veprën por vetëm e ka sqaruar pozicionin e tij si asambleist, kështuqë rrjedhimisht konsideron se ka ardhur edhe tek aplikimi i gabuar i së drejtës materiale dhe vendimit mbi gjobën, etj. andaj propozon që ankesa e ushtruar të aprovohet si e bazuar kurse aktvendimi i atakuar të prishet edhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kolegji vlerësoi thëniet në ankesën e paraqitur, aktvendimin e atakuar, deklarimin e të pandehurit të dhënë në seancën e shqyrtimit pranë gjykatës së shkallës së parë më datë 13.11.2012 ku pos tjerash deklaroi se nuk ka kryer obligimin ligjor të deklarimit të pasurisë për çdo vit (aludohet në deklarim të rregullt vjetor), nga dëshmia e dëshmitarit Agron Behrami zyrtar i AKK Prishtinë të dhënë më datë 06.11.2012 i cili dëshmon për obligimin e zyrtarëve të lartë për deklarim të rregullt dhe për dërgimin e formularëve për deklarimin e pasurisë e që e shkaron se si dhe ku të gjendet formulari për deklarim dhe si të plotësohet i njëjti etj. por duke u bazuar edhe në shkresat tjera të lëndës, andaj ankesën e paraqitur e aprovoi si të bazuar, kurse aktvendimin e atakuar e abrogoi dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kolegji vendosi për abrogimin e aktvendimit të atakuar për shkak të:

- shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kundërvajtëse dhe
- vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike.

DPK/DMP

02

03-1242/13

23.04.2013

2.

Dispozitivi i aktvendimit është i pakjartë dhe jo i plotë.

Kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse e ngarkon të pandehurën për mos deklarim të pasurisë nga neni 5,6 par.1.3 dhe neni 9 të Ligjit nr.04/L-050 e që ndëshkohet sipas neni 17 1.3, pra e pandehura ngarkohet **për mos deklarim të pasurisë sipas kërkesës së Agjencisë**, kurse në dispozitiv të aktvendimit i pandehuri shpallet përgjegjëse për mosdeklarim të pasurisë- pa e cekur fare kohën e kryerjes gjegjësisht periudhën për të cilën i pandehuri nuk e ka përmbushur obligimin ligjor, nuk është theksuar se cili obligim konkret ligjor nuk është përmbushur duke pas parasysh llojet e deklarimit të parapara në nen.6 të të njëjtit ligj, përderisa kërkesa e ushtruar e ngarkon decidivisht për mosdeklarim të pasurisë sipas kërkesës së Agjencisë, përderisa procedura nga gjykata e shkallës së parë është zhvilluar në drjetim të vërtetimit të **mosdeklarimit të rregullt vjetor**, pra nga gjykata e shkallës së parë nuk është vepruar sipas kërkesës dhe nuk është vërtetuar gjendja faktike për të cilën e ngarkon kërkesa të pandehurën, dhe nga deklarata e zyrtarit të AKK-së nuk është kërkuar skjarim se lidhur me pretendimet nga kërkesa për fillimin e kundërvajtjes, kështuqë i pandehuri ndëshkohet sipas neni 17 1.3 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik, pra shpallet përgjegjës dhe dënohet për mosdeklarim të pasurisë **me kërkesën e agjencisë**, pa u vërtetuar se nga Agjencia i është kërkuar konkretisht deklarimi i tillë, lëshime këto që aktvendimin e atakuar e bëjnë të paqëndrueshëm.

Në plotësim procedure gjykata e shkallës së parë duhet të veproj sipas vërejtjeve të theksuara më lartë, duke iu përmbajtur kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse, të merr në pyetje ushtruesin e kërkesës i cili do të deklarohet se për cilin lloj të mosdeklarimit e ngarkon të pandehurën, të administroj edhe ndonjë provë tjetër eventuale dhe më në fund duke pas parasysh edhe pretendimet nga Ankesa e ushtruar, të merret aktvendim i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Nga sa u tha më lartë, konform neni 222 të Ligjit mbi Kundërvajtjet u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E APELIT NË PRISHTINË,

ka.nr.351/13 të datës 02.04.2013.

Procesmbajtëse,
Sebahate Hoti



KRYETARI I KOLEGJIT,

Dalip Bega

